



Leolinda Gjokaj



BASHKIA BERAT
Nr. 4993/3
Datë 09.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT BERAT

Spektori Juridik

Nr. 1966/2 Prot.

Berat, më 09/07/2018

Lënda: Për verifikim të ligjshmërisë së akteve

Drejtuar: **Z. Petrit SINAJ**

KRYETARI I BASHKISË

BERAT

Në mbështetje të Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut"neni16, pasi verifikova bazueshmërine ligjore të akteve, shprehem:

- Konfirmoj Vendimin nr. 65 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: "Mbi perdorimin e fondit te Sherbimit Social per mbeshtetje financiare per perballimin e shpenzimeve ne raste te vecanta"
- Konfirmoj Vendimin nr. 66 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: " Miratimi i kerkeses se bashkise Berat se bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor per zakordimin e ndihmes financiare per familjen e z.Fatmir Kalluci banesa e te cilit eshte demtuar nga shperthimi i bombules se gazit ,nga buxheti i Bashkise dhe buxheti i vitit 2018 ne Ministrine e Brendshme program "Emergjenca Civile"
- Konfirmoj Vendimin nr. 67 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: "Mbi miratimin e listes se familjeve qe perfitojne grantin e menjehershëm per banesat me kosto te ulet dhe kredi te zbutur nga BKT"
- Konfirmoj Vendimin nr. 68 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: "Për dhenien ne perdorim te ambjentit per ngritjen e sportelit unik te fermereve "AGROPIKA" ne Bashkine Berat."
- Konfirmoj Vendimin nr. 69 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: "Mbi miratimin e strehimit ne banesat sociale me qira te familjes se znj.Edije Shehu .
- Konfirmoj Vendimin nr. 70 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: "Për miratimin e listes perfundimtare te inventarit te pronave te paluajtshme publike shteterore e transferohen ne pronesi ose ne perdorim bashkise Berat ,te ndodhura ne Njesine Administrative Otllak."

- Konfirmoj Vendimin nr. 71 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Për miratimin e fondeve per ndertimin e murit mbajtes ne Lagjen nr.2 dhe rikonstrukcionin e murit mbajtes te rruges Duhanas (prane Ures se Duhanasit) “
- Konfirmoj Vendimin nr. 72 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Mbi miratimin e Projektit te Pare te Programit Afatmesem te Bashkise Berat 2019-2021” .
- Konfirmoj Vendimin nr. 73 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Raporti Vjetor i konsoliduar i zbatimit te buxhetit te Bashkise Berat dhe njesive te varesise per vitin 2017” .

• **Nuk Konfirmoj** Vendimin nr. 74 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Per dhenie ndihme financiare te menjehershme per rast fatkeqesie per mjekim te specializuar jashte shtetit per znj T.Mucogllava” ,pasi ne referencat ligjore te VKB nuk shprehet dhenia e ndihmes financiare me vendimarrje te Keshillit Bashkiak.

Referuar VKM Nr.493, datë 6.7.2011”Për disa ndryshime në vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të këshillit të ministrave "për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”

“Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet.....- sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje kirurgjikale apo një trajtim mjekësor i gjatë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast.

- Konfirmoj Vendimin nr. 75 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Per nje ndryshim te VKb nr 98 date 15.12.2017 per miratimin e Buxhetit te Bashkise Berat per vitin 2018 dhe PBA 2018 2020,ndryshimi i pikes 2” .

• **Nuk Konfirmoj** Vendimin nr. 76 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Per anulimin e pjesshem te VKB nr 31 dat e 19.03.2018”Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKB nr57 date 28.12.2015”Per sistemin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Berat “ i ndryshuar “ me argumentet e meposhteme :

Referuar shkreses se Bashkise Berat me nr 4493/1 prot ,date 0307.2018 , depozituar ne institucionin e Prefektit te Qarkut Berat me nr 1965/2prot, date 03.07.2018 ,procesverbaleve te mbledhjes te Keshillit Bashkiak Berat dhe rendit te dites te mbledhjes date 27.06.2017 konstatohet :

VKB nr.76 eshte propozuar jashte rendit te dites nga keshilltaret. Projekt vendimi dhe relacioni shpjegues per kete vendimarrje nuk eshte pergatitur nga ekzekutivi i bashkise, pra nga ana proceduriale kjo vendimarrje eshte ne kundërshtim me ligjin nr 139/2015 “Per VeteQeverisjen Vendore” neni 51 dhe neni 54.

• **Nuk Konfirmoj** Vendimin nr. 77 datë 27.06.2018 të Këshillit të Bashkisë Berat me objekt: “Per nje ndryshim ne VKB nr 8 date 31.01.2017 “mbi kriteret e licensimit te mjeteve autoveture (4+1) dhe (8+1) vende ne sherbimin taksi” me argumentet e meposhtem:

Referuar shkreses se Bashkise Berat me nr 4493/1 prot ,date 0307.2018 , depozituar ne institucionin e Prefektit te Qarkut Berat me nr 1965/2prot, date 03.07.2018, procesverbaleve te mbledhjes te Keshillit Bashkiak Berat dhe rendit te dites te mbledhjes date 27.06.2017 konstatohet :

VKB nr.77 eshte propozuar jashte rendit te dites nga keshilltaret. Projekt vendimi dhe relacioni shpjegues per kete vendimarrje nuk eshte pergatitur nga ekzekutivi i bashkise, pra nga ana procedurale kjo vendimarrje eshte ne kundersizim me ligjin nr 139/2015 “Per VeteQeverisjen Vendore” neni 51 dhe neni 54.

PREFEKTI I QARKUT

Harilla Dafa

